- **Natasha Koço Milo**, e datëlindjes; 12.03.1952 me Nr ID F25312062G, kryefamiljare, pensioniste me të ardhura 17 171 lekë/muaj, nuk ka pasuri të paluajtëshme referuar vërtetimit hipotekor ASHK datë 04.04.2023. Sipas çertifikatës familjare në përbërje të cilës ka të birin Roland Milo (i divorcuar) i cili është duke vuajtur dënimin, gjithashtu ka në përbërjen familjare edhe nipin Enea Milo i datëlindjes 08.10.2004 i cili me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë Nr 999/P-355 datë 24.10.2007 për lënie fëmije për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore Roland Milo. Në këto kushte Natasha Milo përballon të gjitha shpenzimet familjare përfshi edhe përkujdesjen dhe rritjen e nipit vetëm me pensionin e saj, pasi i biri ende është duke vuajtur dënimin.
- **Flutura Fadil Beqo** e datëlindjes 12.08.1971 me Nr ID 15812076P, kryefamiljare, e divorcuar. Referuar çertifikatës familjare ka edhe të birin Vehbi Rrjollli i datëlindjes 07.12.1997, banore e Qytetit Përmet, sipas të dhënave të regjistrimit hipotekor ASHK Përmet datë 31.03.2023 është në 1/5 pjesë takuese e pasurisë 13/84+1-1 me sip 75.68 m², e cila është nën normat e strehimit, e pa punë.
- **Elisabeta Isuf Telhaj**, kryefamiljare, e datëlindjes: 17/07/1985, me Nr ID 155717028A familje e pastrehë, banore e qytetit Përmet me qera sipas kontratës noteriale të qerave nr rep 871 datë 24.08.2023, me përbërje familjare 3 persona me dy fëmijë të mitur të datëlindjes: 25/04/2006 dhe 05/08/2009 sipas të dhënave të gjeneruara nga sistemi i strehimit në aplikimin me Nr BS240820230007 datë: 24/08/2023, nuk ka pasuri të paluajtëshme referuar vërtetimit hipotekor ASHK Përmet datë 03.02.2023, e punësuar në privat me pagë neto 38 750/lekë.
- **Nadire Hyda Lile**, e datëlindjes 02/06/1962 me Nr ID G25602166E, kryefamiljare e divorcuar. Ka paraqitur kërkesën në sistemin e strehimit me numër aplikimi: #BS051220230012 datë 05/12/2023. Referuar të dhënave nga Sistemi i Strehimit ka në përbërje familjare 5 persona, të birin Ardiol Bushi i datëlindjes 19/09/1996 dhe të bijën Sofika Bushi (e divorcuar) e datëlindjes 19/04/1994 nipin Juan Bushi i datëlindjes 18/05/2020 dhe Amari Bushi i datëlindjes 11/08/2023. Nuk kanë pasuri të paluajtëshme apo ndonjë ambient që mund të përdoret për strehim referuar vërtetimit hipotekor ASHK datë 21.08.2023, e punësuar në sektorin publik të pastrim-gjelberimit bashkia Përmet me pagë neto 35 520 lek. Aktualisht banon në qytetin Përmet me qera me adresë Lagja Partizani.
- **Guri Barjam Beqiri** i datëlindjes; 05/07/1970 me Nr ID H00705217N, kryefamiljar i vetëm. Ka paraqitur kërkesën në sistemin e strehimit me numër aplikimi: #BS080620230003 datë 08/06/2023. Referuar të dhënave nga Sistemi i Strehimit me gjendje beqar: Është person me aftësi të kufizuar. Nuk ka pasuri të paluajtëshme apo



ndonjë ambient që mund të përdoret për strehim referuar vërtetimit nga ASHK Përmet. Është familje pa të ardhura. Aktualisht banon në banesë me qera sipas deklaratës noteriale Nr. rep 594 kol 393 datë 15.08.2024.

- **Vasilika Vangjel Mamillo**, e datëlindjes 27/07/1999 me Nr. ID J957270320, kryefamiljare e divorcuar sipas Vendimit të Gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit Gjyrokastër Nr 120/21-2024-693 datë 24.04.2024. Ka paraqitur kërkesë në sistemin e strehimit me numër aplikimi BS260720240007 datë 26/07/2024. Referuar të dhënave nga Sistemi i Strehimit me Gjendje civile: Divorcuar ka në përberje fëmijë të mitur të birin Onel Gjokthomi i datëlindjes 22/10/2020. Nuk kanë pasuri të paluajtshme apo ndonjë ambient që mund të përdoret për strehim. Familje pa të ardhura. Aktualisht banon në banesën e prindërve të saj referuar edhe deklaratës noteriale Nr rep.8 datë 04.01.2024.
- **Fabiola Hyqmet Toska** e datëlindjes 27.06.1985 me Nr.ID I55627028 B është në proces divorci, me dy fëmijë. Në bazë të vërtetimit datë 30.06.2025 të lëshuar nga Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Dr.AKPA Gjyrokastër kjo shtetase rezulton si punëkëruese pranë Zyrës Vendore të Punësimit ZV/AKPA Gjyrokastër. Është familje pa të ardhura, nuk ka banesë jeton me qera në banesën e kumatës, referuar deklaratës noteriale Nr.779 Rep,Nr.440 Kol datë 25.06.2025.
- **Valentina Muharrem Canollari** e datëlindjes 07.03.1968 me Nr.ID G85307034 G, është e divorcuar me një fëmijë e me baba të panjohur. Sipas vërtetimit të lëshuar nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës rezulton se në emër të shtetases Valentina Canollari nuk ka pasuri të paluajtshme të regjistruar në regjistrin elektronik. Është familje pa të ardhura dhe jeton me qera referuar deklaratës noteriale Nr.860 Rep,Nr.571 Kol datë 09.09.2025.
- **Bleona Novruz Çarçani** e datëlindjes 28.05.1998 me Nr.ID J85528067E është e ve me një fëmijë. Sipas vërtetimit të lëshuar nga Agjensia Shtetërore Kadastrës rezulton se në emër të shtetases Bleona Canollari nuk ka pasuri të paluajtshme të regjistruar në regjistrin elektronik. Është familje pa të ardhura dhe jeton me qera referuar deklaratës noteriale Nr1254 Repertori,Nr714 Koleksioni datë 10.09.2025.
- **Anila Jorgo Mingo (Tiko)** e datëlindjes 31.01.1983 me Nr .IDI35131031B e divorcuar me dy fëmijë. Sipas vërtetimit të lëshuar nga Agjensia Shtetërore Kadastrës rezulton se në emër të shtetases Anila Tiko nuk ka pasuri të paluajtshme të regjistruar në regjistrin elektronik. Është familje pa të ardhura dhe jeton me qera referuar deklaratës noteriale Nr.1406 Repertori,Nr780 Koleksioni datë 06.10.2025.
- **Romin Robert Jorgji** i datëlindjes 21.09.1989 me Nr.ID I90921089B, kryefamiljar, në gjendje të vështirë ekonomike me të ardhura minimale me dy fëmijë. .Sipas vërtetimit të lëshuar nga Agjensia Shtetërore Kadastrës rezulton se në emër të shtetasit Romin Jorgji nuk ka pasuri të paluajtshme të regjistruar në regjistrin elektronik. Është familje pa të ardhura dhe jeton me qera referuar deklaratës noteriale Nr.987 Repertori,Nr638 Koleksioni datë 10.10.2025.



Ekleva Vangjel Beqo e datëlindjes 06.08.1976 me Nr.ID H65806019S familje me pesë anëtarë dhe ka një fëmijë men aftësi të kufizuar. Sipas vërtetimit të lëshuar nga Agjensia Shtetërore Kadastrës rezulton se në emër të shtetases Ekleva Beqo nuk ka pasuri të paluajtshme të regjistruar në regjistrin elektronik. Është familje me të ardhura mesatare dhe jeton me qera referuar deklaratës noteriale Nr.1501 Repertori,Nr.840 Koleksioni datë 21.10.2025.

- **Sofi Kolo Gogo** e datëlindjes 03.12.1953 me Nr.ID F36203098H është grua e ve,kryefamiljare me të ardhura të pakta mujore. Sipas vërtetimit të lëshuar nga Agjensia Shtetërore Kadastrës rezulton se në emër të shtetases Sofi Gogo nuk ka pasuri të paluajtshme të regjistruar në regjistrin elektronik. Është familje që jeton me qera referuar deklaratës noteriale Nr.1577 Repertori,N r901 Koleksioni datë 01.11.2025.
-
- **Petrit Skënder Jaupi,i** datëlindjes 14.10.1962 me Nr.ID G21014057 K është invalid,kryefamiljar me të ardhura të pakta mujore. Sipas vërtetimit të lëshuar nga Agjensia Shtetërore Kadastrës rezulton se në emër të shtetasit Petrit Jaupinuk ka pasuri të paluajtshme të regjistruar në regjistrin elektronik. Është familje që jeton me qera referuar deklaratës noteriale Nr. 1203 Repertori,Nr.685 ,Koleksioni datë 03.09.2025.

3. Përfundime:

Duke analizuar gjendjen e familjeve të cilat kanë përfituar bonus qeraje me VKB për vitin 2025, si dhe duke vlerësuar gjendjen aktuale të këtyre familjeve,të cilat referuar dokumentacionit nuk kanë ndryshuar status ekonomik-familjar sidomos të familjeve të divorcuara, familjeve me të ardhura të pakta, me probleme shëndetësore, të komunitetit egjiptian pensionistë, i propozojmë Këshillit të Bashkisë që këto familje në rast se nuk u ndryshojnë kushtet e strehimit apo kushtet ekonomike të vazhdojnë ta përfitojnë bonusin e qerasë edhe për vitin 2026 .

Komisioni i strehimit:

Kryetar Arjana Papapano 

Anetar Enea Kushe 

“ “ Vangjela Naqe

“ “ Lisalda Lako

Jurigen Simoni 



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET**

P/VENDIM

Nr. _____ dt _____ / _____ /2025

PËR

**MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MESATARE TË APARTAMENTEVE NË
TREGUN E LIRË PER VITIN 2026 NË BASHKINË PËRMET.**

Këshilli Bashkiak Përmet i mbledhur më datën ____/____/2025, në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 dt 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr.22/2018”Për strehimin social” i ndryshuar, VKM Nr 459 dt. 03.07.2019 “Për rregullat për Subvecionimin e qirasë dhe mënyrën e financimit”, pika 2/b dhe pika 10, Vendim Nr.301, Datë 15.4.2020 “Për Normat e Strehimit si dhe Kushtet e Standardet për banesat Sociale me Qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, Vendim Nr. 384, Datë 12.6.2019 “Për Përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur Strehim sipas çdo programi Social të Strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga Organet e Vetëqeverisjes Vendore” pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga komisioni konsultativ i strehimit dhe me propozim të Kryetari të Bashkisë.

VENDOSI:

- 1- Të miratojë qiranë mesatare të apartamenteve në treg për vitin 2026 në Bashkinë Përmet si më poshtë:

Për apartamente të tipit Garzionere : 6 000 lek.

Për apartamente të tipit 1+1 : 7 000 lek.

Për apartamente të tipit 2+1 : 9 000 lek.

- 1- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni i Strehimit, Drejtoria e Financë-Buxhetit-Taksa Tregje,Zyra e Aseteve dhe Shërbimeve Publike në Bashki.
- 2- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI I BASHKISË
ALMA HOXHA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

KOMISIONI KONSULTATIV I STREHIMIT

RELACION

PËR

**MBI MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MESATARE TË APARTAMENTEVEË NE
TREGUN E LIRE PER VITN 2026 NE BASHKINË PËRMET**

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Përmet

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 dt 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social", VKM Nr 459 dt. 03.07.2019 "Për rregullat për Subvecionimin e qirasë dhe mënyrën e financimit", pika 2/b dhe pika 10, Referuar këkesave të shumta të qytetarëve për bonusin e qirasë edhe sipas dokumentacionit rezultojnë familje në nevojë si dhe me probleme familjare te cilat mund te perfitojne nga keto banesa. Me qellim llogaritjen e qerases sociale per familjet qe plotesojne kriteret eshte e nevojeshme miratimi i mases së qerases për Bashkine Permet ne varesi te llojit te apartamentit te qerases sociale ne treg.

a) Të përgjithshme:

Një nga format e trajtimit me strehim të familjeve në nevojë është dhënia e subvencionit të qirasë në tregun e lirë, i cili ka nisur si iniciativë ne Bashkinë e Permetit në vitin 2020 me 8 familje dhe ne vitin 2023 nr i perfitueseve te bonusit te qirase arriti ne 30 familje.

Bashkia e Permetit ka vijuar me ofrimin e përfitimit të bonusit të strehimit, ku sipas së cilit subvencionohet një pjesë e konsiderueshme e qirasë së banesës, për familjet të cilat jetojnë me qira dhe kanë të ardhura të pamjaftueshme për ta përballuar atë.

Programi i banesave sociale me qira është programi, me anë të të cilit jepen me qira banesat në pronësi publike nga fondi publik i banesave sociale, si dhe banesat që janë në pronësi të pronarit social.

Banesat sociale me qira përfshijnë:

a) banesat sociale që ndërtohen ose blihen nga tregu i lirë, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim që të jepen me kontratë qiraje sociale;

b) banesat ekzistuese në treg, në pronësi të pronarit social.

Aktualisht ne Bashkine Permet trajtohen me qera sociale 30 familje. Referuar kerkesave te depozituara ne Bashki per perfitimin nga programet sociale te strehimit ky numer eshte variabel ne funksione te kushteve te perfitueseve per vitin ne vazhdim.

b) Kufijtë e të ardhurave të individëve/familjeve që përfitojnë nga banesat sociale me qira?

1. Nga fondi i banesave sociale me qira, jo më pak se 80 për qind e familjeve që përzgjidhen të trajtohen në banesa sociale me qira duhet të kenë të ardhura nga 0 deri 100 për qind të të ardhurave mesatare familjare të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse.
2. Pjesa tjetër, jo më shumë se 20 për qind e familjeve mund të përzgjidhet brenda intervalit 100–120 për qind të nivelit të të ardhurave mesatare.

c) Përcaktimi i qirasë

1. Kur banesat sociale me qira financohen nga buxheti i shtetit ose buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore, ose kombinimi i të dyjave, masa e qirasë, e shprehur në lekë/m² sipërfaqe ndërtimi llogaritet nga struktura përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore, brenda kufirit të përcaktuar në pikën 2 më poshtë.
2. Masa e qirasë miratohet me vendim të këshillit të njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas metodikës për llogaritjen, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Masa e qirasë vjetore nuk duhet të jetë më e madhe se 3 për qind e kostos së ndërtimit të banesës nga institucionet shtetërore, për banesat e reja, ose 3 për qind e vlerës së banesës së blerë në treg, përveç rastit të përcaktuar në pikën 5 më poshtë.
4. Për objektet e dala jashtë funksionimit dhe ato të kthyera në fond banesash sociale me qira, masa e qirasë përcaktohet nga këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas pikës 2, më sipër, bazuar në vlerën kapitale të transferuar dhe kostot e ndërhyrjes për përshtatjen e tyre.
5. Kur banesat sociale me qira financohen nga fondet e investimeve të buxhetit të shtetit kur njësia e vetëqeverisjes vendore ka ngritur strukturën përgjegjëse për menaxhimin e strehimit ose ka përcaktuar përgjegjësitë në një nga strukturat ose ka hartuar programin 5-vjeçar të strehimit, masa e qirasë përcaktohet nga subjektet që e kanë financuar dhe njësia e vetëqeverisjes vendore dhe miratohet me vendim të këshillit të njësive të vetëqeverisjes vendore ku zbatohet projekti.
6. Masa e qirasë, e shprehur në lekë për metër katror, duhet të mbulojë kostot për administrim, mirëmbajtje, kosto operacionale dhe kosto të investimit ose të shlyerjes së borxhit. Niveli i qirasë sociale nuk duhet të jetë më i lartë se niveli mesatar i qirasë në tregun e lirë.

d) Rregullat e përgjithshme mbi subvencionimin e qirasë.

1. Subvencionimi i qirasë si rregull kryhet nga të ardhurat e njësive të vetëqeverisjes vendore. Subvencionimi i qirasë mund të bëhet edhe nga pushteti qendror, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 35, të këtij ligji.
2. Aplikimi i individit/familjes për të përfituar nga subvencionimi i qirasë do të bëhet pranë njësive të vetëqeverisjes vendore. Lista e përfituesve për subvencionimin e qirasë miratohet nga këshilli i njësive të vetëqeverisjes vendore ku ndërtohet banesa. Kur subvencionimi i qirasë financohet pjesërisht ose plotësisht nga qeverisja qendrore, lista e përfituesve, e miratuar nga bashkia, i përcillet ministrisë përgjegjëse për strehimin, e shoqëruar me kërkesën për financim.

3. Përparësi në subvencionimin e qirasë sipas sistemit të pikëzimit kanë, por pa u kufizuar në to, kategoritë e mëposhtme: a) individët me statusin e jetimit; b) personat me aftësi të kufizuara; c) të moshuarit; ç) invalidët e punës; d) familjet e policëve të rënë në detyrë; dh) emigrantët e rikthyer; e) punëtori emigrant; ë) azilkërkuessit; f) familjet e komunitetit rom; g) familjet e komunitetit egjiptian; gj) Viktimat e dhunës në familje; h) viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit; i) prindërit e vetëm, që kanë në ngarkim fëmijë; j) individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktimat për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi që përcakton se si pasojë e diskriminimit individit nuk ka një strehim të përshtatshëm dhe që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 3 të këtij ligji; k) të miturit, 14–18 vjeç, dhe të rinjtë, 18–21 vjeç, në konflikt me ligjin, kur dalin në lirim pas kryerjes së dënimit, kur kanë nevojë për banesë, sepse duhet të jetojnë larg familjeve, për shkak të rehabilitimit të tyre më të mirë në shoqëri; l) vajzat nëna, pas daljes nga programi i banesave sociale të specializuara; ll) familjet me statusin e qiramarrësit në banesa ish-pronë private, sipas aktit normativ nr. 3, datë 1.3.2012. Radhën e përparësisë së kategorive e përcakton këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore me vendim.

e) Subvencionimi i qirasë për banesat në pronësi të pronarit social

1. Subvencionimi i qirasë për banesat bëhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, **me miratimin e këshillave të njësisë të vetëqeverisjes vendore** të veta, kur nuk kanë fond të lirë banesash sociale me qira, si rregull kur: a) nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg; b) ndërtimi ose blerja e banesave nga tregu është më i kushtueshëm sesa subvencionimi i qirave; c) familja është në kushtet e emergjencës për strehim dhe kur nuk përfiton nga një program tjetër.

2. Bëjnë përjashtim nga kushtet e parashikuara në pikën 1, më sipër, rastet kur njësitë e vetëqeverisjes vendore konstatojnë se: a) familja që kërkon të strehohet në banesa sociale me qira banon në një banesë me qira, e cila ndodhet pranë vendit të punës, shkollës së fëmijëve, qendrave shëndetësore ose pranë shërbimeve të tjera; b) banesa sociale me qira është siguruar me financim nga persona juridikë privatë dhe qiraja është sipas pikës 5, të nenit 30, të ligjit nr.22/2018.

ë) Administrimi i subvencionit të qirasë në pronësi të pronarit social

1. Subvencioni paguhet drejtpërdrejt në llogari të pronarit, ndërsa qiramarrësi përfiton vetëm të drejtën për të përdorur banesën me qira. Subvencioni i qirasë jepet **me miratimin e këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore**, në përputhje me buxhetin që jepet çdo vit për subvencionimin e qirave, sipas nenit 33, të ligjit nr.22/2018, dhe bazuar në kriteret që duhet të plotësojë familja për të përfituar subvencionimin e qirasë sipas këtij ligji.

2. Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategori të përcaktuara në pikën 3, të nenit 34, të këtij ligji, nëpërmjet buxhetit të shtetit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Përcaktimi i vlerës së subvencionit të qirasë në tregun e lirë

1. Vlera e subvencionit të qirasë mund të jetë deri në 100 për qind e vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë për njësinë e vetëqeverisjes vendore ku jepet ky subvencion. Vlera maksimale e subvencionit të qirasë përcaktohet çdo vit, bazuar në të dhënat e vitit të mëparshëm,

dhe miratohet me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.
2. Paga që duhet të bëjë familja për diferencën ndërmjet qirasë së tregut dhe vlerës së subvencionimit të qirasë nuk duhet t'i kalojë 25 për qind të të ardhurave të familjes.
3. Mënyra e llogaritjes së vlerës së subvencionimit të qirasë në tregun e lirë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

f) Banesat në treg me Qira

Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve:

Trajtohen me përparësi individët ose familjet që plotësojnë kushtet e nenit 4 pika 1 dhe që kanë këto specifika:

- a) familjet, të cilat vërtetojnë se nuk kanë përfituar nga ligji nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore";
- b) familjet, ku kryefamiljari është grua e ve ose e divorcuar;
- c) familjet njëprindërore, që kanë në ngarkim fëmijë;
- ç) të moshuar që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të perkujdesit shoqëror;
- d) individët me aftësi të kufizuara, të cilët gëzojnë statusin e të verbrit të grupit të parë, të invalidit paraplegjik ose tetraplegjik, të invalidit të punës dhe të invalidit të Luftës Nacionalçlirimtare;
- dh) familjet me shumë fëmijë;
- e) çiftet e reja me moshe totale deri në 55 vjeç;
- ë) familjet që kanë ndryshuar vendbanimin për efekt punësimi;
- f) individët me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga jetimoret ose nga qendrat e perkujdesit e deri në moshën 30 vjeç.
- i) Familjet e komunitetit rom dhe egjiptian.

Ata do të zgjidhen sipas sistemit të pikëzimit, sipas kushteve të mësipërme, bazuar edhe në numrin e anëtarëve të familjes e të ardhurave që marrin. Janë 4 kushte bazike? familjare, sociale, ekonomike, e banimi ato që bëjnë të mundur llogaritjen e pikëve, njëkohësisht edhe seleksionimin. Konkretisht, lidhur me kushtet familjare, trajtohen me përparësi familjet njëprindërore, që kanë në ngarkim fëmijë? të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të perkujdesjes shoqërore? familjet me më shumë se katër fëmijë? si dhe çiftet e reja me moshë totale deri në 60 vjeç, familjet e komunitetit egjiptian.

Ndërsa, sa i përket kushteve sociale, me përparësi do trajtohen personat me aftësi të kufizuara, personat me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e perkujdesjes shoqërore e deri në moshën 30 vjeç? emigrantët e rikthyer? familjet e policëve të rënë në detyrë? viktimat e dhunës në familje? viktimat e trafikimit? komuniteti Rom? komuniteti Egjiptian, të miturit në konflikt me ligjin, pas ekzekutimit të dënimit? dhe të rejtat nëna, që bëhen nëna të vetme.

Perfundime:

Mbas testimit ne treg te cmimit te banesave ne tregun e lire, nga specialistet e strehimit, konstatohet rritje e ndjeshme e cmimit te qirase per apartamente

Ne keto kushte per realizimin e programit te banesave sociale me qera duhet te miratohet ne Keshillin e Bashkise masa e qerese mujore te banesave ne tregun e lire ne Bashkine Permet propozojme qe edhe per vitin 2026 te jete si me poshte:

Për apartamente të tipit Garzionere : 6 000 lek.

Për apartamente të tipit 1+1 : 7 000 lek.

Për apartamente të tipit 2+1 : 9 000 lek.

Duke ju falenderuar

Komisioni i strehimit:

Kryetar Arjana Papapano



Anëtar Lisalda Lako



“ “ Enea Kushe



“ “ Juri gen Simoni



“ “ Vangjela Naqe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P./V E N D I M

Nr. _____, Datë _____.2025

**PËR DHËNIE BURSA DHE PAGESA PËR NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË MESME
PROFESIONALE PUBLIKE PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026.**

Mbështetur edhe në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.666 datë 10.10.2019” Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2025-2026” si dhe në bazë të planit të shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë dhe në vazhdim për nxënësit që kanë përfituar bursë në vitin paraardhës në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mësimor 2025-2026 dërguar me Shkresën e Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit me nr.973/1 Prot, datë 21.10.2015 për planin e shpërndarjes së bursave, me propozim të sektorit Juridik, B.NJ dhe Arsimit

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e bursave të plota për nxënësit e vitit të parë për shkollat e Arsimit të Mesëm Profesional sipas pikës 2.1 (a dhe b) të VKM Nr. 666 datë 10.10.2019 dhe atyre që kanë përfituar në vitet paraardhëse si më poshtë:

1.1 Angjelo Admir Jaupaj i datëlindjes 18.12.2009

Nxënës në klasën e dhjetë sistemi 4 –vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale” Thoma Papapano” Gjirokastër, dega TIK (Teknologji Informacioni dhe Komunikimi

1.2 Anxhelo Agim Muratlari i datëlindjes 01.05.2010

Nxënës në klasën e dhjetë sistemi 4 –vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale” Thoma Papapano” Gjirokastër, dega SHMT(Shërbime Mjetesh Transporti).

- 2 Të rikonfirmojë bursat për nxënësit e vitit të dytë e në vazhdim për shkollat e Arsimit të Mesëm Profesional

2.1 Fjoralb Florenc Kapllani i datëlindjes 29.05.2009

Nxënës në klasën e njëmbëdhjetë sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale Teknike “Demir Progri” Korçë, dega Elektroteknikë.

2.2 Neritan Aldmir Jaupaj i datëlindjes 07.04.2008

Nxënës në klasën e dymbëdhjetë sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale “Thoma Papapano” Gjirokastrë, Dega Termohidraulik

2.3 Grigor Arben Filja i datëlindjes 08.08.2007

Nxënës në klasën e dymbëdhjetë sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale “Thoma Papapano” Gjirokastrë, Dega SHMT (Shërbime Mjetesh Transporti).

2.4 Renato Alban Rakipi i datëlindjes 15.05.2007

Nxënës në klasën e dymbëdhjetë sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale “Thoma Papapano” Gjirokastrë, Dega SHMT (Shërbime Mjetesh Transporti

2.5 Joan Artur Kristo i datëlindjes 26.12.2006

Nxënës në klasën e trembëdhjetë sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale “Thoma Papapano” Gjirokastrë, Dega TIK(Teknologji informacioni dhe komunikimi).

2.6 Eldjon Ardian Ibrahim i datëlindjes 17.09.2006

Nxënës në klasën trembëdhjetë e sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale” Beqir Çela” Durrës, dega Mekanikë

2.7 Gerald Erion Alizoti i datëlindjes 26.08.2006

Nxënës në klasën e trembëdhjetë sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale” Beqir Çela” Durrës, dega Teknologji Informimi Komunikimi (TIK)

Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Zyra Juridike dhe Sektori i Financë- Buxhetit të Bashkisë Përmet.

4. Vendimi hyn ne fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI BASHKISE
Alma HOXHA



RELACION



Mbi kërkesat për bursa për nxënësit që ndjekin vitin e parë dhe vitet në vazhdim, në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mësimor 2025-2026.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak

PËRMET

Mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 666 datë 10.10.2019 me disa ndryshime në VKM Nr 511 datë 27.07.2022 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në intitucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2025-2026”, Shkresën e Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit me nr.973/1 Prot, datë 21.10.2025 dhe në kërkesat e paraqitura ju parashtrojmë:

Pranë Zyrës së Arsimit të Bashkisë Përmet janë paraqitur kërkesat për të përfituar bursë nga aplikantët që ndjekin vitin e parë dhe në vazhdim të arsimit të mesëm profesional publik me të dhëna si më poshtë:

1.1 Angjelo Admir Jaupaj i datëlindjes 18.12.2009

Nxënës në klasën e dhjetë sistemi 4 –vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale” Thoma Papapano” Gjirokastër, dega TIK (Teknologji Informacioni dhe Komunikimi)

1.2 Anxhelo Agim Muratllari i datëlindjes 01.05.2010

Nxënës në klasën e dhjetë sistemi 4 –vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale” Thoma Papapano” Gjirokastër, dega SHMT(Shërbime Mjetesh Transporti

1.3 Fjoralb Florenc Kapllani i datëlindjes 29.05.2009

Nxënës në klasën e njëmbëdhjetë sistemi 4 –vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale Teknike “ Demir Progri” Korçë, dega Elektroteknikë

1.4 Neritan Aldmir Jaupaj i datëlindjes 07.04.2008

Nxënës në klasën e dymbëdhjetë sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale”Thoma Papapano” Gjirokastër, Dega Termohidraulik

1.5 Grigor Arben Filja i datëlindjes 08.08.2007

Nxënës në klasën e dymbëdhjetë sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale”Thoma Papapano” Gjirokastër, Dega SHMT (Shërbime Mjetesh Transporti).

1.6 Renato Alban Rakipi i datëlindjes 15.05.2007

Nxënës në klasën e dymbëdhjetë sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale "Thoma Papapano" Gjirokastër, Dega SHMT (Shërbime Mjetesh Transporti).

1.7 Joan Artur Kristo i datëlindjes 26.12.2006

Nxënës në klasën e trembëdhjetë sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale "Thoma Papapano" Gjirokastër, Dega TIK (Teknologji informacioni dhe komunikimi).

1.8 Eldjon Ardian Ibrahim i datëlindjes 17.09.2006

Nxënës në klasën trembëdhjetë e sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale " Beqir Çela" Durrës, dega Mekanikë

1.9 Gerald Erion Alizoti i datëlindjes 26.08.2006

Nxënës në klasën e trembëdhjetë sistemi 4 -vjeçar, në Shkollën e Mesme Profesionale " Beqir Çela" Durrës, dega Teknologji Informimi Komunikimi (TIK)

Pavarësisht të ardhurave familjare në parim nxënësit si më sipër përfitojnë bursë sipas vendbanimit të përhershëm përcaktuar në pikën sipas pikës 2.1 (a dhe b) të VKM Nr. 666 datë 10.10.2019 "Per kuotat financiare të ushqimit ne mensa e konvikte, percaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në intitucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2025-2026" ku përcaktohet:

2.4. Sipas degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm, nxënësit, të cilët ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional:

b) me vendbanim të përhershëm në zonat verilindore dhe juglindore të vendit: Dibër, Bulqizë, Mat, Kukës, Has, Tropojë, Pukë, Mirditë, Malësi e Madhe, Librazhd, Gramsh, Kolonjë, Përmet, Skrapar dhe Tepelenë.

Nga ana e Zyrës përgjegjëse është bërë verifikimi në bazë të dokumentacionit të kërkuar, nëse ndonjë prej aplikantëve ndodhen në një nga kushtet përjashtuese nga e drejta për të përfituar bursë përcaktuar nga pika sipas pikës 2.1 (a dhe b) të VKM Nr. 666 datë 10.10.2019. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se:

1. Asnjë prej aplikantëve nuk është ndarë nga trugu familjar vërtetuar me Certifikatat familjare të dorëzuara.
2. Asnjë nga anëtarët madhorë të familjes nuk ushtron veprimtari private vërtetuar nga vërtetimet e marra nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër dhe Zyra e Tatim-Taksave të Bashkisë Përmet
3. Aplikantët janë ndjekës për herë të parë në vitin e parë mësimor 2025-2026 dhe përfituesit e mëparshëm.



Sa me sipër argumentuam dhe bazuam, aplikantët plotësojnë kushtet për të përfituar bursë të plotë për vitin mësimor 2025-2026 dhe i kërkojmë Këshillit Bashkiak Përmet miratimin e propozimit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë sipas këtij relacioni.

Specialist Arsim-Kulturë

Ledjan Komino





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET**

P/VENDIM

Nr. ____ dt. ____ / ____ /2025

PËR

**PËR PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË STREHIMIT SOCIAL NË
BASHKINË PËRMET**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54, shkronja "k", të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 2, pika 51 të Ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, Vendim Nr. 384, Datë 12.6.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi Social të Strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga Organet e Vetëqeverisjes Vendore", Vendim nr. 362, datë 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", Vendim nr. 453, datë 3.7.2019 "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti" VKM Nr 459 dt. 03.07.2019 "Për rregullat për Subvecionimin e qirasë dhe mënyrën e financimit", VKM nr 405 datë 01.06.2016 "Për miratimin e strategjisë së stehimit social 2016-2025" pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Komisioni konsultativ i strehimit, Zyra e Shërbimeve Publike, dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë social, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I :

Të miratojë ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Strehimit Social në Bashkinë Përmet.

1. Pranë Bashkisë Përmet ngrihet dhe funksionon Komisioni i Strehimit Social.
2. Komisioni i Strehimit shqyrton dhe mer vendime në lidhje me kërkesat e paraqitura nga cdo subjekt që kërkon për të përfituar nga njëri prej programeve sociale të strehimit, si dhe cdo çështje tjetër që parashikohet nga legjislacioni për strehimin apo akteve të tjera ligjore e nënligjore që përcaktojnë shqyrtimin e kërkesave nga ky komision.
3. Komisioni i strehimit përbëhet nga 5 anëtarë, si më poshtë:

- | | |
|---|---------|
| 1. Drejtori i Strukturës Përgjegjëse për Mbrojtjen dhe Përfshirjen Sociale. | Kryetar |
| 2. Përfaqësues i Drejtorisë Juridike. | Anëtar |
| 3. Përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Finances | Anëtar |
| 4. Specialisti i strehimit. | Anëtar |
| 5. Administrator shoqëro | Anëtar |

4. Komisioni i Strehimit asistohet nga Zyra për Çështjet Sociale dhe e Shërbimeve Publike të cilat asistojnë komisionin gjatë gjithë veprimtarisë së tij, dhe janë përgjegjëse për:

- a. Marrjen në dorëzim të aplikimeve dhe kërkesave që janë objekt i shqyrtimit dhe vendimmarrjes së Komisionit;
- b. Marrjen në dorëzim të aplikimeve dhe kërkesave që janë objekt i shqyrtimit dhe vendimmarrjes së Komisionit;
- c. Shpërndan dhe vë në dispozicion të anëtarëve, materialet për mbledhjen e radhës, brenda 5 ditëve pune para datës së mbledhjes;
- d. Njofton Kryetarin e komisionit për çdo kërkesë të paraqitur për shqyrtim dhe u njofton anëtarëve datën e marrjes në shqyrtim të kërkesës/aplikimit;
- e. Dhënie e mendimit kur i kërkohet nga komisioni, mendim i cili pasqyrohet në proces-verbalin e mbledhjes;
- f. Mban, harton dhe nënshkruan process-verbalin e mbledhjes;
- g. Zbardh vendimin e arsyetuar të marrë në mbledhjen e Komisionit;
- h. Ruan konfidencialitetin.
- i. Çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga Kryetari apo Komisioni i Strehimit.

5. Drejtoria Juridike, e Aseteve dhe Licencimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar të caktojnë përfaqësuesit e tyre në këtë komision.

6. Ngarkohen Komisioni i Strehimit, Nënkyetari i Bashkisë, Zyra e Shërbimeve Sociale, Zyra e Financës, Zyra e Shërbimeve Publike Zyra Juridike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Zyra e Nd.Ekonomike dhe Kujdesit Social për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETARI I BASHKISË
ALMA HOXHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOMISIONI KONSULTATIV I STREHIMIT



RELACION

**NË LIDHJE ME PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË
STREHIMIT SOCIAL NË BASHKINË PËRMET**

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Përmet.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54, shkronja "k", të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 2, pika 51 të Ligjit Nr.22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, Vendim Nr. 384, Datë 12.6.2019 "Për Përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur Strehim sipas çdo programi Social të Strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga Organet e Vetëqeverisjes Vendore", Vendim nr. 362, datë 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", Vendim nr. 453, datë 3.7.2019 "Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti" VKM Nr 459 dt. 03.07.2019 "Për rregullat për Subvencionimin e qirasë dhe mënyrën e financimit", VKM nr 405 datë 01.06.2016 "Për miratimin e strategjisë së stehimit social 2016-2025" paraqesim për shqyrtim relacionin Këshilli Bashkiak, në lidhje me përbërjen dhe funksionimin e Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë Përmet si më poshtë:

A. Të përgjithëshme:

Programet sociale të strehimit, janë programe, të cilët shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore. Këto programe janë objekt i veprimtarisë së këtij Komisioni. **Ky komision në përputhje me normat juridike, sa herë ka në zbatim një program social strehimi, do të shqyrtojë kërkesat dhe dokumentacionin për të bërë të mundur, vlersimin teknik sipas sistemit të pikezimit të miratuar në Këshill Bashkiak, të listës emërore të personave aplikues, me qëllim sigurimin e transparencës dhe efijences së tij, si organ kolegial përballë aplikuesëve.**

I. Cilat janë programet sociale të strehimit sipas legjislacionit të strehimit social?

- a) programi i banesave sociale me qira, në vijim BSQ;
- b) programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri;
- c) programi i banesave me kosto të ulët, në vijim BKU;
- d) *programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi;*
- e) *programi për krijimin e banesave të përkohshme;*

Sheshi "Abdyl Frashëri"; tel. +35581322254; ëeb: ëëë.bashkiapermet.gov.al; e-mail: info@bashkiapermet.gov.al

f) programi i banesave të specializuara.

Komisioni i strehimit social do të ketë në veprimtarinë e tij vlerësimin e kërkesave të aplikuesëve si dhe përcaktimin e listës së përfituesëve në programet të cilat zhvillohen nga Bashkia.

II. Cilat janë rregullat e përzgjedhjes që aplikohen nëpërmjet sistemit të pikëzimit?

1. Përzgjedhja e subjekteve dhe familjeve përfituese bëhet nëpërmjet një sistemi pikëzimi, i cili miratohet dhe publikohet për çdo program nga njësia e vetëqeverisjes vendore.
2. Në përzgjedhjen e subjekteve përfituese me anë të sistemit të pikëzimit përfshihen individë/familje, të cilët përmbushin nivelin e të ardhurave të parashikuara sipas çdo programi.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë, miratojnë dhe publikojnë sistemin e pikëzimit, për çdo vit, të specifikuar për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore dhe për çdo program që zbatohet në ato.
4. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore duhet të sigurojë listat e përfituesve brenda një afati dymujor, nga data e njoftimit nga ana e subjektit publik ose privat që ofron dhe realizon një nga programet sociale të strehimit, kur ky subjekt nuk është vetë njësia e vetëqeverisjes vendore. Marrëdhënia e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe subjektit që financon projektin përcaktohet me marrëveshje të posaçme.
5. Hartimi i listës së përfituesve kryhet nga zyra përgjegjëse ose struktura e ngarkuar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore. Lista e përfituesve dhe dokumentacioni përkatës vlerësohet nga komisioni i strehimit dhe miratohet nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

III. Cilat janë kriteret e përzgjedhjes së përfituesve?

Njësia e vetëqeverisjes vendore, në përzgjedhjen e individëve/familjeve përfituese, për hartimin dhe miratimin e sistemit të pikëzimit bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a) Kushtet e strehimit, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që: i) nuk disponojnë banesë në pronësi; ii) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje; iii) banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi; iv) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore; v) familjet ose individët që humbasin banesën e tyre, si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor; vi) banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike.
- b) Kushtet familjare, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi: i) familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna; ii) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;

IV. Verifikimi i gjendjes ekonomike dhe sociale të familjes

Mënyra e verifikimit

1. Mbështetja nga buxheti i shtetit dhe buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore për përfituesit nga programet sociale të strehimit jepet pas verifikimit të gjendjes ekonomike e financiare të familjes.
2. Verifikimi i gjendjes ekonomike të familjes kryhet nga administratorët shoqërorë, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore.

B. Programet e strehimit social të cilat aplikohen në Bashkinë Përmet.

a) programi i banesave sociale me qira, në vijim BSQ:

Cfarë është programi i banesave sociale me qira?

Programi i banesave sociale me qira është programi, me anë të të cilit jepen me qira banesat në pronësi publike nga fondi publik i banesave sociale, si dhe banesat që janë në pronësi të pronarit social.

Sheshi "Abdyl Frashëri"; tel.+35581322254; ëeb:ëëë.bashkiapermet.gov.al; e-mail:info@bashkiapermet.gov.al

Banesat sociale me qira përfshijnë:

a) **banesat sociale që ndërtohen** ose blihen nga tregu i lirë, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim që të jepen me kontratë qiraje sociale;

b) **banesat ekzistuese në treg, në pronësi të pronarit social;**

c) **objektet e dala jashtë funksionit, si rezultat i mbylljes së një veprimtarie, të cilat kanë kaluar në pronësi të njërive të vetëqeverisjes vendore dhe, në përputhje me planin e përgjithshëm vendor, janë miratuar për t'u kaluar në fond banesash sociale me qira, që subvencionohen.**

b) programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri

Cfarë është programi për përshtatjen e përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave?

Me përmirësim të kushteve të banesave ekzistuese dhe, nëse është e nevojshme, deri në ndërtim të ri, kuptohet tërësia e punimeve që duhet të kryhen, me qëllim që banesa të shndërrohet në një strehim të përshtatshëm, sipas kushteve të parashikuara në nenin 4 të ligjit 22/2018

Cilët janë përfituesit nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit?

Nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit, si dhe përmirësimit deri në ndërtim të ri përfitojnë familjet/individët, të cilëve u mungon një strehim i përshtatshëm.

2. Përparësi në trajtimin me këtë program kanë:

- a) personat me aftësi të kufizuara;
- b) individët me statusin e jetimit;
- c) familjet e policëve të rënë në detyrë;
- ç) të moshuarit;
- d) komuniteti rom;
- dh) komuniteti egjiptian;
- e) komunitetet e zonave rurale;
- ë) prindërit e vetëm;
- f) viktimat të trafikimit /viktimat të mundshme të trafikimit;
- g) viktimat të dhunës në familje.

Cilat janë objektet/banesat që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve?

Objektet dhe banesat, që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve ose i përmirësimit të kushteve deri në ndërtim të ri, janë:

- a) objektet/banesat në rrezik shembjeje;
- b) objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme.

